



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-PR-2020-09

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, kryetar i panelit
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 maj 2020

Gjuha: anglishte

Titulli i dosjes: Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provvave në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit

Klasifikimi: publik

Vendim mbi gjuhën e punës

1. Më 29 dhe 30 prill 2020, në mbledhjen e tyre plenare, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës miratuan ndryshime të Rregullores së Procedurës dhe të Provave Para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").¹ Gjykatësit kushtetues nuk morën pjesë në miratimin e tyre.
2. Më 1 maj 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës, në pajtim me nenin 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji")², ia referoi ndryshimet e lartpërmendura Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma").
3. Në të njëjtën ditë, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin e Gjykatës Kushtetuese me përbërje si më lart për shqyrtimin e ndryshimeve në Rregullore, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe nenin 55 të saj.
4. Në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores së Punës për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, paneli vendos gjuhët e punës në procedurat para tij. Paneli vendos që gjuha e punës e kësaj procedure të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, të mundësuar nga Zyra Administrative.

¹ KSC-CC-PR-2020-09, F00001, Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik me shtojcë konfidenciale, 1 maj 2020.

² Po aty.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Vendos që gjuha e punës e kësaj procedure të jetë anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, të mundësuar nga Zyra Administrative.

____/nënshkrim/____

Gjykatës Vidar Stensland

Kryetar i panelit

Hartuar në anglishte, e enjte 7 maj 2020

Në Hagë, Holandë